



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Leksikologji

Ngarkesa: 4 ECTS, 20 orë leksione, 20 orë seminare

Viti / Semestri: Viti II , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Përmbledhje e modulit:

Lënda e leksikologjisë synon të jetë një studim sistematik i sistemit leksikor të frëngjishtes moderne e cila synon të thellojë zotërimin e studentëve në gjuhën frënge, si dhe t’u sigurojë atyre aftësitë e nevojshme për analizën leksikore të teksteve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Objektivi kryesor i këtij moduli është t’u japë studentëve të vitit të dytë njohuritë e nevojshme dhe solide mbi organizimin, funksionimin dhe tendencat aktuale të sistemit leksikor modern francez, në mënyrë që t’i ndihmojnë ata të zotërojnë dhe të përdorin më mirë gjuhën frënge.

Objektivat specifike lëndore:

- Të përcaktojë vendin dhe rëndësinë e leksikologjisë në studimet gjuhësore, si dhe marrëdhënien që ajo ka me degët e tjera të gjuhësisë.
- Të japë një panoramë të përgjithshme të leksikut të gjuhës frënge të konceptuar si sistem.
- T’i iniciojë studentët në semantikën leksikore.
- Të studiojë marrëdhëniet që ekzistojnë midis fjalëve.
- Të përshkruajë burimet e brendshme dhe të jashtme dhe mjetet për pasurimin e leksikut.
- Të studiojë shtresat e ndryshme të leksikut të gjuhës frënge.
- Të sigurojë njohuri për frazeologjinë dhe lidhjet midis leksikut dhe kulturës.